

Nr.      Prot.

Durres, me 00.00.2009

## **KONTRATE**

Sot, me date \_??/\_??/\_ 2009, prane Agjensise Detare Shteterore "Taulantia" sh.a. lidhet kjo kontrate midis paleve:

- **Agjensise Detare "Taulantia" Sh.A.**  
Me adrese Lagjia 4 Rr."Skenderbej" Pallatet SIAC,  
Tel, 00355 52 2222 33 , 230733 Fax 00355 52 222911  
Adrese e-maili [info@taulantia.com.al](mailto:info@taulantia.com.al) faqe web [www.taulantia.com.al](http://www.taulantia.com.al)  
Me numer NIPTI J61811533K  
me perfaqesues Drejtorin, z. Rezart KTHUPI
  
- **Dhe agjensise**  
Me adrese:  
Tel/Fax :  
Adrese e-maili  
Me numer NIPTI  
E perfaqesuar nga Administratori i saj, Z./Znj.  
Numri i IP:

Baza ligjore : Ligji 7850 date 29.07.1884 Kodi Civil i Republikes se Shqiperise , si dhe te gjitha ndryshimet e mevonshme.

### **Neni 1** **EMERTIMI**

Ne kete kontrate Agjensia Detare "Taulantia" sh.a. do te quhet "agjenti" dhe agjensia "X" do te quhet "nenagjenti".

### **Neni 2** **OBJEKTI**

Objekti i kontrates është dhënia nga ana e agjentit ne favor te nenagjentit e se drejtes se shitjes se biletave per udhetare dhe autovetura, ne emer te tij dhe per llogari te agjentit.

Dhënia e kesaj te drejte është konform rregullave te percaktuara ne kontraten e lidhur me kompanine italiane te lundrimit Gruppo Tirrenia.

Vendosja e cmimeve per biletat e pasagjereve dhe automjeteve eshte e drejte ekskluzive e Kompanise Tirrenia prone e se ciles eshte edhe sistemi i emetimit te biletave .

Emetimi i biletave nga nenagjenti do te kryhet nepermjet sistemit te Kompanise Tirrenia ne te cilin nenagjenti mund te hyje nepermjet faqes se internetit <http://booking.tirrenia.it>

### **Neni 3** **AFATI**

Kontrata fillon me date \_\_??.\_\_??.2009 dhe perfundon me date 31.12.2009.

Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere pas nenshkrimit nga dy palet dhe kur jane plotesuar kushtet e kerkuara ne nenin 5 te saj.

Ne rast te mos rinovimit te saj 1 muaj perpara perfundimit te afatit, kontrata konsiderohet e lidhur edhe per nje vit tjeter. Ne perfudim te afatit te perseritur, rilidhja e kontrates eshte e detyrueshme dhe moskryerja e ketij veprimi konsiderohet si zgjidhje automatike e saj.

### **Neni 4** **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENTIT**

Agjenti merr persiper ti siguroje nenagjentit nje IP(indentit protokoll) dhe nje Password (fjalekalim) me te cilet nenagjenti do te kete te drejte te hyje ne faqen e brenshme te sistemit te emetimit te biletave te Kompanise Tirrenia.

Agjenti eshte i detyruar te jape te gjitha ndihmen e nevojshme intelektuale me qellim permiresimin e aftesive te nenagjentit ne perdorimin e sistemit te emetimit te biletave.

Agjenti eshte i detyruar qe pas perfudnitmit te rakordimeve dhe paraqitjes se fatures perkatese t'i njohe dhe paguaje nenagjentit komisionin e rakorduar me pare per punen e kryer. Ky komision do t'i njetet dhe paguhet nenagjentit per periudhen kalendarike te nje muaji duke filluar nga data 01 e muajit dhe deri ne perfundimin e tij. Rakordimet per mbylljen e muajit do te behen prane zyrave te agjentit nga data 01 deri 05 e muajit pasardhes.

Agjenti ka per detyre aktivizimin e sistemit te emetimit te biletave, gjithnje brenda afatit te kontrates, sa here qe nenagjenti depoziton shumen e percaktuar ne kete kontrate si parapagese per emetimin e biletave. Ky aktivizim nuk do te kryhet me vone se 24 ore nga derdhja e shumes se kerkuar.

Agjenti ka te drejten e bllokimit te sistemit te emetimit te biletave te nenagjentit ne rastet kur ky i fundit :

- Nuk vepron ne perputhje me udhezimet e agjentit apo te Kompanise Tirrenia
- Kur ka realizuar ne emetim biletash te gjitha shumen e depozituar si parapagese
- Kur nuk eshte realizuar rinovimi i kontrates

- Per cdo shkak tjeter jo te parashikuar ne kontrate por qe mund te interpretohet nga zakonet e vendit si shkelje e normave dhe rregullave ne marrdheniet kontraktuale.

Agjenti ne çdo kohe rezervon te drejten per te bere korrigjimet e nevojshme ne detyrimet e nenagjentit apo ne komisionet qe i jane njohur ketij te fundit kur verteton se ka pasur gabime apo veprime te tjera te pasakta ne to. Gjithesesi kjo e drejte mund te ushtrohet vetem ne perfundim te muajit dhe me ane te rakordimeve me nenagjentin.

Agjenti gjithashtu rezervon te drejten, ne baze te kontrates me Kompanine Tirrenia per te bere ndryshime ne procedurat e emetimit te biletave apo ne cmimet e tyre, me kusht qe te njoftoje nenagjentin me shkrim brenda nje afati kohor te arsyeshem.

Agjenti ka per detyre te njoftoje menjehere nenagjentin kur kredia e ketij te fundit ndaj agjentit eshte me e vogel se 500 euro. Gjithesesi duke prezumuar qe nenagjenti eshte ne dijeni te xhiros se realizuar prej tij dhe te kredise qe ai ka prane agjentit, mosrealizimi I ketij detyrimi nuk e pengon agjentin te kryeje pezullimin e kontrates kur nenagjenti realizon xhiro sa vlera e kredise qe ai ka prane agjentit.

Agjenti nuk mban asnje pergjegjesi per pasagjeret e pajisur me bilete nga nenagjenti, te cilet nuk udhetojne per faj te tyre ( paraqitje me vonese ne traget, mungese dokumentacioni, etj).

Agjenti nuk mban pergjegjesi per demin qe i shkaktohet udhetarit ne rast se anijet e kompanise se lundrimit per shkaqe madhore (kushte atmosferike te renduara, etj.) nuk udhetojne. Ne keto raste bileta dhe prenotimi relativ e ruajne vlefshmerine per datat pasardhese. Ne rast mosudhetimi te anijes edhe ne daten e mevonshme, bileta do te rimbursohet ne vleren 100% prane nenagjentit qe e ka leshuar.

### **Neni 5**

#### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E NENAGJENTIT**

Nenagjenti, ne baze te kontrates, kryen sherbimin e biletarise se kompanise Gruppo Tirrenia.

Ai do te kete te drejten e rezervimit per pasagjere dhe autovetura vetem prane agjentit ndaj te cilit detyrohet. Ai nuk ka te drejte qe t`ua kaloje te drejten e shitjes se biletave te marra personave te trete

Biletat e shitura nga nenagjenti duhet te jene detyrimisht te vulosura me vulen e tij .

Per sherbimin e kryer nenagjenti gezon te drejten qe ne funksion te xhiros mujore te realizuar prej tij mbi bazen e biletave te shitura, te perfitoje nje komision qe varion si me poshte:

- 1- Deri ne 5000 EURO vlere neto e biletave te shitura e zhveshur nga te gjitha taksat– 7%
- 2- Nga 5001-15000 EURO vlere neto e biletave te shitura e zhveshur nga te gjitha taksat – 8%
- 3- Mbi 15000 EURO vlere neto e biletave te shitura e zhveshur nga te gjitha taksat – 9%
- 4- Per biletat e grupeve Nenagjenti perfiton nje komision fiks prej 9 % mbi vleren neto te biletas

Procedura e rimbursimit te biletave do te perputhet me udhezimet qe ndodhen ne kapakun e cdo bilete, e me konkretisht:

- 1- Biletet se kthyer deri 1 dite para dates se udhetimit i mbahet 10% e vleres.
- 2- Biletet se kthyer daten e udhetimit i mbahet 25% e vleres.
- 3- Biletet me date te hapur i mbahet 10% e vleres.
- 4- Bileta nuk kthehet pasi i kalon data e udhetimit.

Duke iu referuar pikes me lart nenagjenti ka per detyre te informoje klientin per kushtet e kthimit te biletet, dhe ti sqaroje keta te fundit, ne rast te kthimit ne traget (nga policia), per t'u paraqitur menjehere prane zyres se imbarkimit me qellim kryerjen e veprimeve perkatese te kthimit te biletet apo te ndryshimit te dates. Ne te kundert bileta do te rezultojte e pavlefshme .

Nenagjenti detyrohet qe ne momentin e lidhjes se kontrates te dorezoje nje Ekstrakt nga QKR me te dhenat e historikut te subjektit, Ky dokument duhet te jete origjinal dhe i leshuar jo me shume se nje muaj nga data e dorezimit. Objekti i veprimtarise ekonomike te nenagjentit duhet te kete te beje me transportin ose turizmin.

Nenagjenti është i detyruar qe perpara lidhjes se kontrates te beje derdhjen e nje shume prej jo me pak se 1500 (njemijepeseqind) Euro per llogari te Agjentit. Kjo shume do te sherbeje si parapagese per biletat qe do te emetoje nenagjenti per llogari te agjentit.

Ne momentin kur nenagjenti ka kaluar realizuar shume prej 1500 Euro me bileta te shitura atehere duhet te beje parapagese ne banke per te vazhduar punen normalisht. Kjo parapagese nuk do te jete me e vogel se 1000 (njemije) Euro. Ne rast te mos kryerjes se kesaj parapagese nenagjenti nuk do te lejohet te vazhdoje emetimin e biletave.

Nenagjenti është i detyruar te paraqitet çdo fillim muaji (datat 1 – 5) per te mbyllur llogarine e muajit paraardhes, per te kryer rakordimet perkatese prane agjentit si dhe per te bere percaktimin e komisioneve sipas kategorizimeve te paraqitura me lart. Pas ketij momenti nenagjentit i lind e drejta e kerkimit te komisionit sipas volumit te punes se realizuar ne nje nga bankat me te cilat ai vepron..

Cdo veprim monetar do te shoqerohet me fatuaren perkatese si nga agjenti dhe nga nenagjenti.

## **Neni 6**

### **PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E KONTRATES**

Kontrata pezullohet menjehere nese:

1. Nenagjenti barazon ose kalon shumen e parapaguar.
2. Nenagjenti nuk paraqitet ne fillim te muajt per te bere rakordimet perkatese.
3. Nenagjenti nuk bene derdhjen per llogari te nenagjentit te komisioneve qe i takojne ketij te fundit.

Kontrata zgjidhet menjehere nese:

1. Ne te gjitha rastet kur pas pezullimit ka kaluar nje periudhe prej nje muaj.
2. Nenagjenti nuk respekton detyrimet qe dalin nga kjo kontrate dhe sidomos detyrimet qe rrjedhin nga neni 5 i kesaj kontrate.
3. Nenagjenti falimenton kur eshte person juridik dhe humbet zotesine per te vepruar ose vdes kur eshte person fizik.

**Neni 7**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

Nese palet kontraktuese do te kene mosmarreveshje midis tyre, do te mundohen t'i zgjidhin ato nepermjet bisedimeve dy paleshe.

Nese edhe pas ketyre bisedimeve nuk arrihet ndonje rezultat, atehere kompetente per zgjidhje e tyre është Gjykata e Shkalles se Pare Durres.

Kjo kontrate hartohet ne tre kopje, nga te cilat dy mbahen nga agjenti dhe tjetra i dorezohet nenagjentit.

Kontrata pasi u lexua dhe u kuptua, u firmos rregullisht nga palet kontraktuese.

**Per Agjensine Detare**  
**"TAULANTIA" SH.A.**  
**Rezart KTHUPI**

---

**DREJTOR**

**Per Agjensine**

---

**ADMINISTRATOR**